



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA

Nr. _____ Prot.

Patos, më ____ . ____ . 2024

ALBPETROL SHA PATOS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Data 22.07.2024

Nga: “Albpetrol” sha – Patos

Drejtuar: OE, “VESA 2014” shpk, me NUIS L42612401O, me adresë: Lagjja 16 Prill, Rruga Llukan Toska, afer Stadiumit, Fier.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-11399-06-27-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Tel avolzhimi + materiale ndihmëse”

Kohëzgjatja e kontratës është 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 34 datë 1 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ARTEO 2018” shpk, me NUIS L82523203F , me vlerë oferte në total 3,699,400 lekë (pa TVSH).
2. Operatori Ekonomik “SARK” shpk, me NUIS K52531415H , me vlerë oferte në total 3,266,000 lekë (pa TVSH).
3. Operatori Ekonomik “VESA 2014” shpk, me NUIS L42612401O , me vlerë oferte në total 3,808,730 lekë (pa TVSH)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

* * *

- Operatori ekonomik “ARTEO 2018” shpk, me NUIS L82523203F nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit , konkretisht:

- OE nuk ka paraqitur furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Furnizimet e paraqitura nga OE nuk kanë ngjashmëri me objektin e procedurës. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.1. të pikës 2.3. “*Kapaciteti teknik*”, të pikës 2. “*Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit*”, të shtojcës 7 të DST-së.
- OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per artikujt e kerkuar. Autorizimi I paraqitur për OE është I distributorit “SALI ELEKTRIK” për furnizimin me elektropompa, zhytëse, centrifugale, materiale ndriçimi. Autorizimet prodhuesve për distributorin janë në gjuhën angleze të papërkthyer dhe të panoterizuara. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të pikës 2.3. “*Kapaciteti teknik*”, të pikës 2. “*Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit*”, të shtojcës 7 të DST-së dhe me kërkesën e AK ku specifikohet që: ***Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.***
- OE nuk ka paraqitur katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese per artikujt objekt prokurimi. Katalogu I paraqitur nga OE është I shoqërisë “ALBBAKËR”, shoqëri e cila nuk ka lëshuar autorizim prodhuesi për distributorin e OE “SALI ELEKTRIK”. Për më tepër faqja nr. 43 e këtij katalogu, pikërisht faqja e specifikimeve teknike për telin e avolzhimit, nuk është pjesë e katalogut të shoqërisë “ALBBAKËR”, por është e një kompanie Turke “SARKUYSAN”. Ky fakt jo vetëm që nuk është ligjor por as serioz nga ana e OE. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.4. të pikës 2.3. “*Kapaciteti teknik*”, të pikës 2. “*Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit*”, të shtojcës 7 të DST-së
- Operatori ekonomik “SARK” shpk, me NUIS K52531415H nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit , konkretisht:
- OE nuk ka paraqitur furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Furnizimet e paraqitura nga OE, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës nuk kanë ngjashmëri me objektin e procedurës. Furnizimet e tjera të paraqitura nga OE, nuk janë të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.1. të pikës 2.3. “*Kapaciteti teknik*”, të pikës 2. “*Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit*”, të shtojcës 7 të DST-së.
- OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per artikujt e kerkuar. Autorizimi I paraqitur nga prodhuesi “SAHRA KABLLO” është në gjuhën angleze i papërkthyer dhe i panoterizuar. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të pikës 2.3. “*Kapaciteti teknik*”, të pikës 2. “*Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit*”, të shtojcës 7 të DST-së dhe me kërkesën e AK ku specifikohet që: ***Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.***

- OE nuk ka paraqitur katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese per artikujt objekt prokurimi. Katalogu u paraqitur nga OE është I prodhuesit Italian “ICEL”, I cili nuk ka lëshuar asnjë autorizim prodhuesi dhe nuk lidhet as me distributorin dhe as me OE. Ky katalog është në gjuhën italiane, I papërkthyer dhe I panoterizuar. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.4. të pikës 2.3. “Kapaciteti teknik”, të pikës 2. “Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit”, të shtojcës 7 të DST-së dhe me kërkesën e AK ku specifikohet që: ***Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip***

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “VESA 2014” shpk, me NUIS L426124010, me adresë: Lagjja 16 Prill, Rruga Llukan Toska, afer Stadiumit, Fier se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,808,730 (tre milion e tetëqind e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

* * *

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eltar DEDA